


20 Vite

Histori Suksesi



Përmbajta

Profili i Sigal Uniqa Kosovë	4
Produkte Inovatore	6
Ndarja e tregut të sigurimeve në Kosovë	7
Çmimet dhe vlerësime ndërkombëtare	8
Misioni i kompanisë	10
Parimet që na udhëheqin	10
Më shumë se një kompani sigurimi	11
Një jetë më të mirë për të gjithë	12

Avni Ponari

CEO SIGAL UNIQA Group Austria



Gjithçka nisi me një rrugëtim që u konkretizua në shkurt 1999, por që ishte nisur shumë më herët. Ishin 5 veta, 1 zyrë dhe një kapital prej vetëm 400 mijë dollarësh. Ndërsa sot kryesojnë tregun, janë në avantgardë me kompanitë simotra dhe numërojnë mbi 2100 punonjës e agjentë dhe mbi 1150 zyra. Ka qenë një rrugëtim i gjatë, i lodhshëm, me shumë sfida, por edhe i bukur kur shikon se sa shumë besim i ka dhënë qytetarëve, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Shumëkujt sot i duket e pabesueshme, por kur e dashuron diçka çdo vështirësi zbehet dhe bëhen të papërfillshme. Po flasim për SIGAL, kompaninë lider të sigurimeve, fillimisht në Shqipëri e më pas në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Është pak e vështirë të rikthehesh 24 vite pas kur lindi ideja për të zhvilluar një kompani sigurimesh private. Unë vij nga shkolla e Marinës, ky është edukimi im i lartë, të cilin e kam mbaruar në Vlorë. Në atë kohë, vetëm Marina ishte e përfshirë në sistemin e sigurimeve. Anijet shqiptare ishin të vetmet të siguruara, pasi nuk mund të lundronin në asnjë port të botës pa qenë të siguruara. Ndaj, sigurimi ishte një nga lëndët që ne bënim në shkollën e lartë.”

Pasi u largova nga detyra e rëndësishme që kisha në vitin 1992, fillova punë në kompaninë e parë të sigurimeve, në departamentin e marinës (të cilin e krijova unë). Më tej, në vitet '96 - '97, krijuam ligjin për liberalizimin e tregut të sigurimeve dhe unë isha pjesë e hartimit të këtij ligji. Ndërsa në vitet '98 -'99, filluam përgatitjet për të krijuar e kompaninë e parë të sigurimeve së bashku me disa miq të mi që punonin në sigurime.”

PROFILI SIGAL UNIQA KOSOVË

GRUPI "SIGAL UNIQA" – Grup Rajonal Sigurimesh

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, e themeluar më 22 shkurt 1999 fillimisht si SIGAL sh.a, është një nga grupet më të mëdha të sigurimeve në rajon.

Sot, pas afro 25 vjetësh në treg, SIGAL UNIQA operon me sukses në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut nëpërmjet 8 kompanive të saj, nga të cilat 6 janë kompani të sigurimit të jetës dhe jo-jetës; 1 shoqëri risigurimi (e vetmja në rajon) dhe 1 fond pensioni privat.

Të përkushtuar dhe me profesionalizëm, mbi 2300 punonjës dhe agjentë të SIGAL UNIQA shërbejnë në mbi 1200 zyra në 3 shtete (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut) me standardet tërësisht evropiane duke qenë pranë mbi 1,2 milion klientëve atëherë kur ata kanë më shumë nevojë.

SIGAL UNIQA zotëron rreth 20% të tregut rajonal të sigurimeve, ndërsa zë vendin e parë në tregun shqiptar (rreth 28%) dhe atë kosovar (rreth 14%).

22,400

Punonjës &
Partner Ekskluzivë

16 milion

Klientë

17


Shtete

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA - Kosova

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA - Kosova u themelua në vitin 2003 në kuadër të ndërkombëtarizimit të aktivitetit të SIGAL sh.a përmes blerjes së një kompanie ekzistuese të sigurimeve.

SIGAL Kosova është licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të përgjithshëm të jo-jetës.

Ndërsa në vitin 2011 do të themelohej edhe SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA, e licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si kompani e sigurimit të jetës.



Pjesë e UNIQA Insurance Group

Prej marsit të vitit 2007, Grupi "SIGAL UNIQA" është pjesë e "UNIQA INSURANCE GROUP", njëkohësisht edhe aksioneri më i madh 86.9%. "UNIQA Insurance Group" është një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në tregjet e saj kryesore të Austrisë dhe Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE). Rreth 22,400 punonjës dhe partnerë ekskluzivë të shitjeve u shërbejnë pothuajse 16 milionë klientëve në 17 shtete: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki dhe Ukrainë. Përveç kësaj, kompanitë e sigurimeve në Zvicër dhe Lihtenshtajn janë gjithashtu pjesë e Grupit UNIQA.

UNIQA, e themeluar në vitin 1881, është grupi i dytë më i madh i sigurimeve në Austri ku zë rreth 21% të tregut.

— Produkte Inovatore

SIGAL UNIQA Group Austria është e vetmja kompani që ofron të gjitha klasat e sigurimit, Jetë, Jo-Jetë dhe Pension Privat.


Produktet tona

- Aksidentet dhe sigurimet shëndetësore
- Sigurimi motorik
- Sigurimi i aviacionit
- Sigurimi i pasurisë
- Sigurimi i garancisë
- Sigurimi i jetës
- Sigurimi i sëmundjeve kritike
- Sigurimi i marinës dhe i transportit
- Sigurime inxhinierike
- Sigurimi i përgjegjësisë
- Sigurimi i financave


Ndarja e tregut të sigurimeve në Kosovë

SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë është kompania lider e sigurimeve, si për pozicionin që zë në treg ashtu edhe për dëmet e paguara tek klientët e saj. Kompania zë 14% të tregut në sigurimet e Jo-Jetës dhe është e para edhe në pagimin e dëmeve, 19% të totalit të 12 kompanive të sigurimit që operojnë në Kosovë. Ajo zë rreth 12% të tregut në sigurimet e detyrueshme dhe mbi 17% në ato vullnetare.


Përveç sigurimeve motorike dhe të shëndetit, SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë është kompania më e besuar edhe në Sigurimin e Pasurisë teksa sipas raportit më të fundit nga BQK, zë 37,5% të tregut.



Sigurimet e
Jo-Jetës



Të totalit të 12 kompanive
të sigurimit që operojnë
në Kosovë.



Tregu i sigurimeve
të Kosovës

Çmimet dhe vlerësimet ndërkombëtare

Por përveç besimit në rritje të qytetarëve, të cilët i besojnë jetën, shëndetin, pronën, biznesin dhe automjetin dhe nuk kanë munguar as vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare për ritmet e progresit të SIGAL UNIQA.

Çmimet e fituara

Top 100 kompanitë e
Sigurimit në Evropën Juglindore

SeeNews

“Tatimpaguesi
i vitit 2022”

Oda Ekonomike e Kosovës

Çmimi “SUPERBRANDS ALBANIA'S
CHOICE 2019/2020”

SUPERBRANDS INTERNATIONAL

“Fairplay Team
2022”

**Federata Sportive
e Punëtorëve të Kosovës**

Nga “Central Finance Europe”:

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fuqisë së aseteve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fuqisë së kapitalit për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas primeve neto të sigurimeve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fi timeve para tatimeve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fi timeve mbi asetet për vitin 2021/22”

Çmimet dhe vlerësimet për “UNIQA Insurance Group”

UNIQA Insurance Group, mes
3 kompanive më të mira
të sigurimit në Evropë

Forbes

“Menaxher i Vitit”
Andreas Brandstetter,
CEO i UNIQA Insurance Group,

Industrie Magazin

“AssCompact
Award 2023”

3 çmime

Çmime të rëndësishme
për “UNIQA Insurance Group”

Medalje ari në “Sigurimin e Aksidenteve” dhe dy medalje të argjendta në “Sigurime Shëndetësore” dhe “Shërbimi më i mirë për Partnerët”.

“Brendi më i mirë i
punëdhënësit për vitin”
2023

Vlersimi me
“A”

Standard & Poor’s

Misioni i kompanisë

SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë është gjithmonë pranë klientëve, atëherë kur ata kanë më shumë nevojë!

Kompania është e fokusuar dhe e angazhuar për të sjellë tek qytetarët dhe bizneset e Kosovës produktet dhe shërbimet në kohë reale, në mënyrën më të lehtë të mundshme, kjo falë edhe aplikacioneve online që mundësojnë blerjen e siguracionit që nevojitet edhe përmes celularit, vetëm me një klikim të shpejtë.

Objektivi kryesor i SIGAL UNIQA Group Austria – Kosovë është investimi i mëtejshëm në teknologjinë dixhitale për ta bërë shërbimin ndaj atyre që na besojnë jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe çdo gjë tjetër me vlerë më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më efikase.



Parimet që na udhëheqin

Klienti i pari

Ne fokusohemi me vendosmëri në nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë duke kërkuar edhe mendimin e tyre.

Përgjegjës

Ne jemi kompani e përgjegjshme, ndaj vazhdimisht kërkojmë zgjidhjet më të mira dhe më të shpejta për klientët tanë.

Thjeshtësia

Ne i japim përparësi përfitimeve të ofruara nga zgjidhjet e thjeshta dhe më të mira.

Integriteti

Ne i qëndrojmë të vendosur vlerave dhe politikave tona në çdo veprimtari. Komunikimi dhe transparenca janë pjesë e përditshmërisë sonë.

Më shumë se një kompani sigurimi

Nën moton “Jetojmë më mirë së bashku”, ne punojmë çdo ditë për ta kthyer këtë biznes, nga një ofrues i produkteve të sigurimit në një ofrues shërbimi të integruar që mbledh klientët e tyre aty ku ata qëndrojnë në “mjedisin e nevojave” të tyre individuale.

Mbështesim sportin

Prej disa vitesh jemi sponsor të skuadrave të ndryshme të basketbollit dhe futbollit, përfshirë mbështetjen ndaj Federatës Shqiptare të Basketbollit. SIGAL Prishtina, një nga skuadrat e mbështetura nga SIGAL UNIQA në Kosovë, ka disa vite që është skuadër kampione. Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, forcimit të marrëdhënieve sociale por edhe “ambasadori” më i mirë i një kombi.

SIGAL UNIQA merr në sigurim futbollistët në Kosovë

Pas futbollistëve të ekipit të Ballkanit, që u fut në histori me kualifikimin në fazën e grupeve të UEFA Conference League, edhe futbollistët e Ferizajt, Drenicës dhe Gjilanit janë pajisur me policat e Sigurimit të Shëndetit nga SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë.

Ne jemi krenarë të themi se:

- Prej më shumë se 18 vitesh SIGAL UNIQA Group Austria mbështet ekipin e SIGAL Prishtina, e cila edhe falë mbështetjes së kompanisë më të madhe të sigurimeve në rajon është shpallur 13 herë kampione e Superligës së Kosovës, ndërsa ka fituar edhe 2 Kupa Ballkanike.
- Jemi sponsor i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe asaj të Basketbollit;
- Jemi sponsor gjeneral i Superligës së femrave në futbollin e Kosovës që mban emrin “SIGAL SUPERLIGA E FEMRAVE”;
- Liga Ballkanike e Basketbollit u riemërua “SIGAL UNIQA Ballkan League” falë bashkëpunimit disa-vjeçar me kompaninë.



Një jetë më të mirë për të gjithë

“SIGAL UNIQA Vital Truck”, e vetmja e këtij lloji në rajon

Me qëllim promovimin e shëndetit të mirë, SIGAL UNIQA Group Austria, nën idenë e gjigantit austriak të financave dhe sigurimeve “UNIQA Insurance Group”, ndërtoi të parën dhe të vetmen Klinikë Lëvizëse Shëndetësore, e cila që prej vitit 2015 ka ofruar vizita dhe ekzaminime shëndetësore falas për mijëra banorë në çdo cep të Shqipërisë, që nga Valbona, Thethi, Lëpusha, Bajram Curri, Bogë, Shkodra, Lezha, Korça, Pogradeci, Elbasani, Tirana, Berati, Vlora, Saranda, Konispoli etj.

“KLINIKA LËVIZËSE SIGAL UNIQA”, prej vitit 2015 ka bërë rreth 4500 km, njësoj si t'i biesh Shqipërisë katër herë rreth e qark.

Nën moton “Më mirë është ta parandalosh një sëmundje se sa ta kurosh atë” klinika e lëvizshme kryen vizita për disa lloje të ndryshme sëmundjesh, duke përfshirë edhe imazheritë e ndryshme që janë të domosdoshme.

SIGAL UNIQA Vital Truck” mundëson një shumëllojshmëri ekzaminimesh, duke nisur nga:



- 1.Vizita dhe konsulta me mjek të përgjithshëm
- 2.Ekzaminimi i gjendjes së përgjithshme
- 3.Peshë-gjatësi-tension,
- 4.Matje e sheqerit në gjak,
- 5.Vizitë e syve dhe veshit për probleme akute/infeksione, etj.,
- 6.Elektrokardiograma e zemrës,
- 7.Echo abdominale,
- 8.Matje e kapacitetit vital të mushkërive,
- 9.Matje e oksigjenit në gjak, etj.

Orkestra e Harqeve "SIGAL UNIQA Group Austria"

Kultura dhe arti është civilizim, ecuri dhe zhvillim i një vendi që lufton të jetë përparimtar drejt asaj çfarë synojmë gjithmonë, demokracinë.

Ndaj dhe SIGAL Uniqa Group Austria nuk ka reshtur së mbështeturi ndër të tjera edhe kulturën, duke i kushtuar një hapësirë shumë të rëndësishme kësaj fushe në mesin e të gjitha projekteve madhore që zhvillohen çdo ditë në duart e një stafi profesionistësh. Por si?

Që prej vitit 2009, Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA ka shërbyer për promovimin e shumë artistëve të rinj dhe të afirmuar në fushën e letërsisë, muzikës dhe arteve pamore. Gjatë vitit 2012 në Klubin e Artit janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA është një shtëpi libri, një galeri arti dhe sallë muzike; thënë ndryshe një vend që mbledh të tre artet në një dhe ju jep mundësinë e kalimit të orëve sa çlodhëse aq edhe informuese mbi emrat e rinj dhe punët më të fundit të artistëve shqiptarë dhe të huaj. Që prej vitit 2013, pjesë e Klubit të Artit është Orkestra e Harqeve e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë.



SIGAL AUDIOBOOKS, e para dhe e vetmja librari dixhitale në shqip

“SIGAL AudioBooks”, platforma e parë dixhitale e librave audio sjell te shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve, pa asnjë kosto, librat e autorëve më të njohur, shqiptarë dhe të huaj.

Te “SIGAL Audiobooks” e gjejnë veten duke filluar që nga fëmijët e moshave të vogla, duke dëgjuar përrallat e tyre të preferuara, fëmijët pak më të rritur me librat shkollorë apo libra artistikë që u përshtaten moshës së tyre dhe deri tek të rriturit, që mund të dëgjojnë romane, histori, kulturë, e plot libra interesantë dhe me vlera të mëdha.

Librat vijnë tek ju nëpërmjet zërave të njohur të personazheve që kanë shumë vite eksperiencë në gazetari dhe jetën publike, dhe me profesionalizmin dhe zërin e tyre unik përcjellin tek çdo dëgjues librat më të mirë të epokës moderne, si dhe të historisë e kulturës së vjetër mesjetare e të rilindjes.

Platforma, tërësisht FALAS, ka për qëllim ruajtjen, zhvillimin dhe trashëgimin brez pas brezi të gjuhës shqipe.



Shifra mbi “SIGAL UNIQA Audiobooks”

+300
libra falas

50k
përdorues

Jetojmë më mirë së bashku

SIGAL UNIQA Group Austria është më shumë sesa një kompani Sigurimi. Ti, unë, ne. Secili prej nesh ka historinë e tij/saj. Por ajo që na bashkon ne të gjithëve është: kujdesja për njerëzit gjë që e kemi treguar me fakte se dimë ta bëjmë shumë mirë.

Së bashku i shërbejmë mbi 1.2 milion njerëzve në 3 shtete (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut) me një objektiv të qartë: për t'ua bërë jetën më të mirë klientëve tanë dhe atyre që janë më afër tyre.

SIGAL UNIQA është më shumë sesa një kompani sigurimi. Me ofertat novatore dhe shërbimin cilësorë, ne vazhdojmë më tej, me përgjegjësi zhvillimin e vetvetes, të shoqërisë dhe të mjedisit tonë.

Ne jemi një partner i besueshëm drejt rrugës për një jetë më të mirë – nëpër të gjitha stuhitë e ndryshimit, krahë për krahë.

Sepse ne jemi të bindur se: **“Së bashku ne jetojmë më mirë”...**



+383 (0) 38 240 241
info@uniqa-ks.com
www.uniqa-ks.com